



Datë: 20.05.2025
Numër Protokolli: 3534/2025

A.nr.513/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.513/2025, të datës 20.03.2025, të parashtruar nga ankuesja F.R, kundër organit të punësimit: Komunës së Kamenicës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.513/2019 e datës 20.03.2025 e parashtruara nga ankuesja, F.R.

II. Shfuqizohet Vendimi me numër 66/2025 i datës 24.02.2025, i Kryetarit të Komunës së Kamenicës.

III. Detyrohet Kryetari i Komunës së Kamenicës që ankuesen nga pika I e këtij vendimi të kthejë në pozitën që ka mbajtur në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, apo në një pozitë ekuivalente brenda këtij institucioni, me status të Nëpunësit të shërbimit publikë.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesja F.R (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 20.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 66/2025 të datës 24.02.2025, të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.01.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa, Këshilli më datë 15.04.2025 ka pranuar përgjigje, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1854/2025 e datës 20.03.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 66/2025 të datës 24.02.2025 i protokolluar më datë 25.02.2025, të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 15.04.2025; Akt Emërimit e datës 06.08.2019; Kërkesën për pezullim të dakorduar të vendit të punës nga ankuesja e datës 19.08.2019; Vendimin e datës 06.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; Kërkesën e datës 06.12.2021 të ankueses; Emailin e datës 21.01.2025 nga Sh.L për L.S; Emailin e datës 21.01.2025 nga L.S për Sh.L; Vendimin e datës 25.06.2019 të Inspektoratit të Punës; Vendimin A.nr.994/2021 të KPMSHCK-së; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 14.02.2019 të ankueses; Vendimin e datës 28.08.2019 për pezullim të përkohshëm të marrëdhënies së punës; Vendimin e datës 30.04.2025 për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës së ankueses.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, **sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë:

-ankuesja F.R sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës të datës 14.02.2019, ka qenë e punësuar në pozitën e punës *Udhëheqëse e Departamentit të Administratës*, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Kamenicës. T

- Kryetari i Komunës së Kamenicës, bazuar në shkresën zyrtare të përcjell më datë 26.03.2019 nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil-Ministria e Administratës Publike dhe Vendimit të Inspektoratit të Punës 354/2019 të datës 25.06.2019, ankueses i ka lëshuar Akt emërimit ashtu që e njëjta është caktuar si Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Kamenicës.

-Ankuesja kundër akt emërimit të datës 06.08.2019, më datë 03.09.2019 kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës, ndërsa, ky i fundit, më datë 01.10.2019, ka nxjerr vendim më të cilën shpall veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses të ditës 03.09.2019.

-Ankuesja më datë 11.09.20219, ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Kamenicës për deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë, më arsyetimin së të gjithë të punësuarit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik.

-Ankuesja më datë 04.11.2019 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 18/2019 të datës 01.10.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës.

-Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.11.2019 ka njoftuar ankuesen që ankesa nuk mund të shqyrtohet për shkak që Këshilli është jofunksional duke e udhëzuar që për procedurat e tjera mund të drejtohet gjykatës në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative.

-Ankuesja ka filluar konfliktin administrativ, ashtu që Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 23.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2712/2019, me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të vendos për ankesën e datës 04.11.2019 të ankuesve, aktgjykim të cilin Komuna e Kamenicës e kishte kundërshtuar më ankesë pranë Gjykatës se Apelit.

-Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka shqyrtuar ankesën e ankueses sipas obligimit të Aktgjykimit A.nr.2712/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ngase nuk ka qenë funksional.

-Gjykata e Apelit e Kosovës më Aktgjykimin AA.nr.14/22, të datë 28.02.2023, ka refuzuar ankesën e Komunës së Kamenicës duke e vërtetuar Aktgjykimin A.nr.2712/2019 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

- Ankuesja më datë 27.05.2024 ka parashtruar kërkesë në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes të cilët ka kërkuar të vendoset për rastin sipas vendimeve të gjykatës.

-Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.09.2024, ka nxjerr Vendim A.nr.994/2021 me të cilin ka aprovuar ankesën me numër A.nr.681/2019 të datës 04.11.2019 dhe ankesën me numër A.nr.05/2022 e datës 06.01.2022 e parashtruar nga ankuesja, ka shfuqizuar Vendimin me numër 02Nr.38846 i datës 28.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Kamenicë, duke e detyruar këtë të fundit që të bëjë ndryshimin e statusit të ankueses nga statusi i nëpunësit të shërbimit civil në statusin e nëpunësit të shërbimit publik, duke e kthyer të njëjtën në pozitën që ka mbajtur në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ose në një pozitë ekuivalente.

-Kryetari i Komunës së Kamenicës me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.02.2025 ka nxjerr Vendimin Nr. 66/2025, me të cilin ka aprovuar pjesërisht kërkesën e ankueses për kthim në vendin e punës duke e transferuar në pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si drejtues i ulët, ndërsa, ka refuzuar kërkesën për kthim në pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë në QKMF.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 66/2025 të datës 24.02.2025, të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, pretendon se vendimi i kontestuar është në kundërshtim të plotë me gjendjen e fakteve dhe si rrjedhojë nuk është zbatuar vendimi i Këshillit.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesve, konstaton se ankuesja ka themeluar marrëdhënie të punës në Komunën e Kamenicës me datë 14.02.2019, mbi bazën e dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ndërsa, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i aplikueshëm në atë kohë të punësuarit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, duke përjashtuar stafin profesional të sistemit shëndetësor janë trajtuar zyrtarë më status të nëpunësit civil, andaj, mbi këtë fakt rrjedhë së ankuesja në pozitën e Udhëheqëses së Departamentit të Administratës në QKMF ka pas statusin e shërbyesës civilë. Në

kontekst të këtij konstatimi Kolegji iu referua nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku parashihej: *“1. Në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përformuesit e artit, zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale.*

Ndërsa më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më datë 20.07.2020 përkatësisht me nenin 2 paragrafi 4 të këtij ligji është përcaktuar se të gjithë të punësuar si pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, **shëndetësisë**, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publik, nga pozita e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike kanë statusin e **Nëpunësit të shërbimit publikë**.

Rrjedhimisht, nga provat e lëndës rezulton se pas fillimit të zbatimit të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ankuesja është trajtuar si nëpunës i shërbimit publikë dhe kështu organi i punësimit ka dërguar edhe listën për deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, mirëpo sipas dispozitave ligjore në fuqi të përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e më konkretisht me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, ka qenë kompetencë e nivelit komunal që vetë ta bëjë deklarimin e statusit dhe atë përmes nxjerrjes së akt administrativ, mirëpo nga provat e lëndës rrjedh se deklarimi i statusit të punës për ankuesen është bërë vetëm mbi bazën e një liste të dërguar në Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji i Këshillit, referuar bazës ligjore si dhe provave të administruara si me lartë konstaton se nga koha kur ka filluar të zbatohet Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, statusi i pozitës së ankueses ka qenë i përcaktuar si Nëpunës i shërbimit publik, edhe pse ankuesja e kishte pezulluar marrëdhënien e punës sipas Vendimit me numër protokolli 26636 të datës 28.08.2019, për shkak të marrjes së funksionit publik si këshilltare e Kuvendit Komunal të Kamenicës. Rrjedhimisht, Kolegji konstaton se edhe përkundër faktit se ankuesja ka pezulluar marrëdhënien e punës në pozitën që ka mbajtur në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila pozitë deri atëherë kishte statusin e pozitës së nëpunësit civil, me hyrjen në fuqi të Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pozita e saj është dashur të trajtohet nga komuna si pozitë e Nëpunësit të shërbimit publikë, kështu që, edhe e njëjta, pas përfundimit të mandatit të këshilltares komunale duhej të sistemohej si nëpunës e shërbimet publikë, duke ruajtur kategorinë dhe klasën të cilën e ka pas para pezullimit.

Andaj, përkundër vendimit të Këshillit A.nr. 994/2021 të datës 04.09.2024, më të cilin ishte anuluar si i paligjshëm Vendimi me numër 02Nr.38846, i datës 28.12.2021, dhe ishte obliguar organi përkatës si punësimit që ankueses t’i ruhet statusi i Nëpunësit të shërbimit publikë, dhe e njëjta të

kthehej në pozitën që ka mbajtur në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, apo në një pozitë ekuivalente brenda këtij institucioni, si Nëpunëse e shërbimit publikë, organi i punësimit në këtë rast Kryetari i Komunës së Kamenicës më vendimin e konsistuar dhe në kundërshtim me vendimin e Këshillit serish ankuesen e sistemon në pozitën *Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Social në Komunën e Kamenicës*, si pozitë e nëpunësit civil.

Kolegji i Këshillit, për sa me sipër dhe duke ju referuar provave të lëndës, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara, kështu që duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të shfuqizoj Vendimin me numër 66/2025 të datës 24.02.2025, të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, për transferimin e ankueses, dhe rrjedhimisht obligoj organin e punësimit që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në kuptim të zbatimit të këtij vendimi, me qëllim që ankueses t'i ruhet statusi i zyrtarit publikë si Nëpunës i shërbimit publikë, dhe e njëjta të kthehet në pozitën që ka mbajtur në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, apo në një pozitë ekuivalente brenda këtij institucioni, si Nëpunëse e shërbimit publikë, si dhe t'ia kompensoj diferencën e pagës për atë kohë sa është dëmtuar si pasojë e transferimit të kundërligjshëm, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.513/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, F.R;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.